



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT TË KONTRATAVE

Nr. 8680 / Prot. 2

Tiranë, më 13.11.2023

REKOMANDIM

MBI

ZBATIMIN E KONTRATAVE

Drejtuar: Autoriteteve/enteve kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), në ushtrim të detyrave të saj sipas parashikimeve në nenin 23, gërma "b" dhe "ç", të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (në vijim "LPP"), me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik që lidhet me zbatimin e kontratave, nisur nga mangësitë dhe problematikat e evidentuara në formularët e raportimit për zbatimin e kontratave të dërguara nga autoritetet kontraktore në formë shkresore apo elektronike, rekomandon si më poshtë vijon:

1. Bazuar në nenin 21 të LPP, autoriteti/enti kontraktor (në vijim "AK") është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, dhe ka detyrimin të mirëplanifikojë fondet publike e të ndjekë procesin deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.

Për sa më sipër, AK duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që zbatimi i kontratave të bëhet në përputhje me kushtet e prokuruarra dhe me legjislacionin në fuqi, duke ndjekur me përgjegjësi ecurinë e tyre dhe duke marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtimin në kohë të problematikave që hasen gjatë zbatimit të kontratës.

Në rastet kur një AK vepron në cilësinë e një organi qendror blerës, sipas parashimeve të nenit 53 të LPP, përgjegjësia e zhvillimit të procedurës së prokurimit që nga njoftimi i kontratës deri te

publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit është kompetencë e këtij autoriteti kontraktor, por nënshkrimi i kontratës dhe ndjekja e zbatimit të saj bëhet nga autoriteti kontraktor përfitues, referuar nenit 67, pika 7, të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (në vijim “VKM”), ku parashikohet se:

“Organi qendror blerës ose autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e. Në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, procedura e prokurimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bëhet nga organi qendror blerës, ndërsa procedura e minikonkurimit për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese”.

Për sa më sipër, autoriteti kontraktor i cili ka nënshkruar kontratën sipas parashikimeve të dispozitës së sipërcituar, duhet të marrë masat për ngritjen pa vonesa të strukturave përkatëse përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të kontratës, në përputhje me VKM dhe me legjislacionin në fuqi.

Njëkohësisht, duhet të merren masa për koordinimin e strukturave të ndryshme të autoritetit kontraktor, si dhe koordinimin me organin qendror blerës, me qëllim që kontrata të zbatohet sipas kushteve të prokuruar.

2. AK duhet të mbajnë në konsideratë që modifikimi i një kontrate kryhet vetëm nëse gjenden në një nga rastet e nenit 127, të LPP.

APP sjell në vëmendje që AK të shmangin modifikimin e kontratave, për situata që mund të parashikohen dhe të planifikohen paraprakisht. Modifikimi duhet t'i shërbejë objektit dhe qëllimit të kontratës fillestare, ndërsa për nevoja të reja që mund t'i lindin autoritetit kontraktor, duhet të planifikojë dhe të prokurojë në kohë një procedurë të re prokurimi.

Gjithashtu, AK duhet të marrin masa që projektet para fazës së prokurimit, pavarësisht periudhës së hartimit të tyre, duhet të jenë të përditësuara në të gjithë elementët, për të shmangur problematikat që mund të shfaqen gjatë zbatimit të kontratës

Në çdo rast AK duhet të mbajnë në konsideratë detyrimin ligjor për dokumentimin e arsyeve dhe argumenteve për modifikimin e kontratës. Referuar nenit 127, pika 6, të LPP, parashikohet se: *“Arsyet dhe argumentimet për modifikimin e kontratës ose të marrëveshjes kuadër duhet të dokumentohen nga autoriteti ose enti kontraktor”.*

3. Në lidhje me modifikimin e afatit të kontratës, AK duhet të mbajnë në konsideratë **vetëm rastet nëse AK ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 127, të LPP**, duke argumentuar dhe dokumentuar përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë nen.

Gjithashtu, AK duhet të mbajnë në konsideratë **kushtet e përgjithshme të kontratës**, në lidhje me vonesat në zbatimin e kontratës dhe zgjatjen e afatit të saj.

Së pari, sjellim në vëmendje që kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë. AK, nga ana e tyre, duhet të marrin paraprakisht të gjitha masat e nevojshme, që lidhen me lirimimin e ambjenteve/sheshit të ndërtimit sipas afatit të parashikuar në dokumentet e tenderit dhe në kontratë, kryerjen e procedurave për marrjen e lejeve që janë të nevojshme për kryerjen e objektit të kontratës, apo masa të tjera që duhet të merren paraprakisht, me qëllim shmangien e vonesave në fillimin e zbatimit të kontratës.

Së dyti, nëse gjatë zbatimit të kontratës, kontraktori ose nënkontraktorët e tij ndodhen në kushte që pengojnë realizimin në kohë të objektit të kontratës, dhe kanë njoftuar me shkrim AK lidhur me vonesën, shkakun e saj dhe kohëzgjatjen e mundshme, AK, duhet të veprojë me shpejtësi për vlerësimin e situatës dhe vetëm nëse përmbushen kushtet ligjore e kontraktore mund të zgjasë afatin e realizimit të kontratës. Në këtë rast, AK duhet të mbajnë në konsideratë që zgjatja miratohet me shkrim nga palët dhe reflektohet në modifikimin e kontratës, sipas parashikimeve të nenit 127, të LPP. Në rastet e parashikuara në nenin 127, pika 3, të LPP, AK duhet të dërgojnë pranë APP formularin e njoftimit për modifikimin e kontratës/marrëveshjes kuadër gjatë kohëzgjatjes së saj, brenda 10 ditëve nga kryerja e modifikimit, në formë shkresore dhe me CD.

Gjithashtu, AK duhet të mbajnë në konsideratë që **me përjashtim të rastit të forcës madhore**, siç parashikohet në kushtet e përgjithshme të kontratës, çdo vonesë nga kontraktori në kryerjen e detyrimeve të furnizimit të mallrave/shërbimeve/realizimit të punimeve sipas grafikut të lëvrimit të mallit/ekzekutimit të shërbimeve/punimeve objekt kontrate, **do ta bëjë kontraktorin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara** në përputhje me parashikimet në kontratë.

Së treti, sjellim në vëmendje që modifikimi i afatit të kontratës kryhet **brenda kohëzgjatjes së saj**.

Në rastet kur ka pezullim punimesh dhe AK ka vlerësuar situatën se janë plotësuar kushtet, duke miratuar me shkrim modifikimin për zgjatje të afatit të kontratës, sipas parashikimeve në LPP dhe në kontratë, AK duhet të raportojë në formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, edhe zgjatjen e afatit të kontratës për shkaqet respektive.

3. AK duhet të mbajnë në konsideratë që zbatimi i kontratave të punëve publike të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Referuar nenit 124, pika 1, të LPP, përcaktohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi”.

Në lidhje me kontratat e punëve publike, sjellim në vëmendje që në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi, AK duhet të caktojë paraprakisht mbikëqyrësin e punimeve dhe nuk duhet të lejojë fillimin e punimeve pa praninë e mbikëqyrësit, i cili caktohet për punimet e ndërtimit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

4. APP sjell në vëmendje të AK që **financimi i kontratave dhe parashikimet për kryerjen e pagesave të detyrimeve kontraktore** të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Njëkohësisht, gjatë zbatimit të kontratave, AK duhet të kryejnë pagesat në përputhje me parashikimet e kontratës dhe me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

